

RAPORTI I NDËRMJETËM 9 – 31 maj 2017

2 qershor 2017

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Një ngërç, i cili zgjati për 3 muaj ndërmjet Qeverisë së kryesuar nga Partia Socialiste (PS) dhe opozitës së kryesuar nga Partia Demokratike, i cila kulmoi me refuzimin e PD-së për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare, nëse nuk plotësoheshin disa kushte, përfundoi më 18 maj me një marrëveshje politike të arritur ndërmjet kryetarëve të dy partive. Marrëveshja, siguroi pjesëmarrjen e opozitës në zgjedhje, dhe i dha mundësinë PD-së të caktojë individë në poste kyçe qeveritare. Gjithashtu data e zgjedhjeve e caktuar më parë, u shty për një javë dhe u vendos më 25 qershor.
- Diskutimet për të ndryshuar kuadrin ligjor zgjedhor pas zgjedhjeve të fundit u bllokuan për shkak të ngërçit politik. Megjithatë, Marrëveshja përfshiu disa ndryshime të vonshme, duke përfshirë fushatën, financat e fushatës, median dhe krimet zgjedhore. Këto ndryshime u kritikuan nga disa bashkëbisedues të OSBE/ODIHR-it për miratimin e tyre të vonuar, mospërputhjen me Kodin Zgjedhor, dhe mungesën e konsultimit paraprak, duke rezultuar në sfida ligjore dhe praktike për autoritetet dhe pjesëmarrësit në garë.
- Deri më 30 maj, do të garojnë në zgjedhje 18 parti politike, duke përfshirë PD-në dhe Partinë Republikane (PR), të cilat u regjistruan pas Marrëveshjes. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) gjobiti dy parti politike, për mos respektimin e kërkesave të kuotave gjinore në listën e tyre të kandidatëve.
- Zgjedhjet administrohen nga një administratë zgjedhore me tre nivele, e cila përfshin KQZ-në, 90 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të), dhe 5362 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të). Numërimi do të zhvillohet në 90 Vende të Numërimit të Votave. Përbërja e komisioneve bazohet në emërime politike. Partitë opozitare, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë në komisionet e dyta dhe të treta, fillimisht refuzuan të caktonin anëtarë për KZAZ-të, duke bërë që KQZ-ja të caktonte anëtarë drejtpërsëdrejti, në përputhje me ligjin. Më 31 maj, pas Marrëveshjes, KQZ-ja shkarkoi të emëruarit e saj dhe i plotësoi vendet vakante me kandidatë nga PD-ja.
- Që prej Marrëveshjes, KQZ-ja duhet të veprojë në rrethana të jashtëzakonshme, duke u përballur me sfida komplekse ligjore, institucionale dhe financiare, përfshirë edhe hartimin e përsheptuar të rregullave, për të sqaruar aspektet e reja të procesit zgjedhor. Më 22 maj, si rezultat i Marrëveshjes, Parlamenti zvendësoi Kryetarin e KQZ-së, duke tejkaluar procedurat e parashikuara ligjore. Pavarësisht këtyre sfidave, KQZ-ja ka vazhduar të kryej takime dhe të publikojë vendimet e saj rregullisht.
- Listat e zgjedhësve janë të disponueshme për shqyrtim publik. Pas Marrëveshjes, u printuan lista të reja, të cilat pasqyrojnë zgjedhësit, që do të mbushin 18 vjeç në datën e re të zgjedhjeve. Nuk ka dispozita për votimin jashtë vendit ose nëpërmjet kutive lëvizëse të votimit. Deri me 24 maj, numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,452,308.
- Disa parti politike kanë zhvilluar takime zgjedhore me zgjedhësit, duke përfshirë edhe periudhën para çeljes zyrtare të fushatës. Ndryshime ligjore të konsiderueshme u miratuan pas Marrëveshjes,

me qëllim uljen e kostos së fushatës zgjedhore dhe fuqizimin e mbikqyrjes së financimit të fushatës. Këto dispozita nuk janë sqaruar ende nga KQZ-ja.

- Mjedisi mediatik është aktiv, por preceptohet gjerësisht si i pozicionuar politikisht. Ndryshimet e fundit ligjore detyrojnë transmetuesit privat të vendosin në dispozicion kohë transmetimi falas për të gjithë garuesit, dhe gjithashtu ndalojnë reklamën politike me pagesë, çka bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, siç është vënë në dukje publikisht nga disa media.

II. PARATHËNIE

Në përgjigje të një ftese të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, dhe duke u bazuar në rekomandimet e Misionit të Vlerësimit të Nevojave, zhvilluar nga data 6 deri më 9 mars 2017, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti më 9 maj një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ).¹ MVZ-ja, kryesuar nga Ambasadori Peter Tejler, përbëhet nga një ekip kryesor me 13 anëtarë me zyrë në Tiranë, dhe 26 vëzhgues afatgjatë, të cilët më 19 maj u vendosën në 12 qarqe në të gjithë vendin. Anëtarët e misionit vijnë nga 23 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Shteteve pjesëmarrëse u është kërkuar të dërgojnë 300 vëzhgues afatshkurtër, për të vëzhguar procedurat e ditës së zgjedhjeve.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet parlamentare të 2013 rezultuan në një shumicë mandatesh për koalicionin e kryesuar nga Partia Socialiste (PS). Kjo u krye nëpërmjet një kalimi paqësor pushteti nga qeveria e mëparshme, drejtuar nga Partia Demokratike (PD)².

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), ka kërkuar bashkëpunim ndërmjet qeverisë dhe opozitës në disa fusha kyçe, në mënyrë që të miratojnë legjislacionin, përfshirë reformën në drejtësi, për të parandaluar mbajtjen e posteve publike nga persona me të shkuar kriminale, si edhe reformën zgjedhore.³ Pavarësisht sulmeve këmbëngulëse dhe vijuese ndërmjet PS-së dhe PD-së, ligji “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (që zakonisht referohet si “Ligji i dekriminalizimit”) u miratua me sukses nga Parlamenti në dhjetor të vitit 2015. Parimet e reformës në drejtësi, që përfshijnë vetting-un për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, gjithashtu u miratuan unanimisht në 2016.⁴ Megjithatë, bashkëpunimi ngeci, kur opozita ankimoi ligjin e vetting-ut në Gjykatën Kushtetuese, e cila më pas miratoi pjesën më të madhe të dispozitave të tij në janar të 2017. Ngërci i mëvonshëm politik çoi në një bllokim të diskutimeve mbi reformën zgjedhore.

Më 5 dhjetor 2016, presidenti thirri zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit 2017. Më 7 shkurt 2017, PD-ja nisi një bojkot parlamentar, duke pretenduar se qeveria ishte e përfshirë në aktivitete kriminale të shumëfishta, dhe po përgatiste një mashtrim zgjedhor të shtrirë në gjithë vendin. PD-ja pretendonte se në kushtet aktuale nuk mund të zhvilloheshin zgjedhje të besueshme, dhe deklaroi se nuk do të merrte pjesë në zgjedhje, nëse nuk do të plotësoheshin disa kërkesa. Kjo përfshinte dorëheqjen e Kryeministrit, krijimin e një qeverie teknike dhe përdorimin e votimit elektronik. Qeveria e kryesuar nga PS-ja refuzoi këto kërkesa dhe pretendoi që PD-ja nuk dëshironte të merrte pjesë në zgjedhje për shkak të mungesës së mbështetjes popullore.

¹ Shiko [gjithë raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it rreth zgjedhjeve në Shqipëri](#).

² Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 2013: “Aleanca për Shqipërinë Europiane” 83 mandate; Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) - 65; Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) - 16; Partia për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) - 1; Partia Kristian Demokratike (PKD) - 1. “Aleanca për Punë, Prosperitet dhe Integrim” - 57 mandate; Partia Demokratike e Shqipërisë (PD) - 50, Partia Republikane e Shqipërisë (PR) - 3; Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) - 4.

³ Shqipëria aplikoi për anëtarësimin në BE më 28 prill 2009 dhe u bë një vend kandidat në qershor 2014.

⁴ Siç rezultoi edhe nga ndryshimet kushtetuese të korrikut 2016 dhe në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” (ligji i “Vetting-ut”) në gusht 2016.

Që prej shkurtit, u bënë disa përpjekje me ndërmjetësimin ndërkombëtar, ku të dyja palët nuk lëvizën nga qëndrimi i tyre. Si rezultat, partitë e opozitës nuk u regjistruan për zgjedhjet para afatit të 9 prillit.⁵ Pas skadimit të të gjitha afateve për regjistrim, dhe pas vendimit të KQZ-së për caktimin e përmbajtjes së fletës së votimit, më 13 maj në Tiranë u zhvillua një protestë e madhe e drejtuar nga PD-ja, duke konfirmuar thirrjen e partisë për pranimin e kushteve të saj në këmbim të pjesëmarrjes në zgjedhje.

Bllokimi përfundoi më 18 maj me arritjen e një marrëveshje politike (Marrëveshja) ndërmjet kryetarëve të PS-së dhe PD-së. Marrëveshja siguroi pjesëmarrjen e PD-së, dhe përcaktoi, që PD-ja do të emëronte individë në disa poste qeveritare kyçe, përfshirë një Zëvendës Kryeministër, gjashtë ministra, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), dhe Avokatin e Popullit. Marrëveshja, parashikonte gjithashtu shtyrjen e zgjedhjeve deri më 25 qershor, si dhe zgjatjen e afateve për regjistrimin e partive dhe kandidatëve deri më 26 maj.⁶

Marrëveshja, u mirëprit gjerësisht nga figura politike kyçe, si edhe nga komuniteti ndërkombëtar, megjithëse disa ngritën pyetje rreth impaktit për mundësitë zgjedhore për partitë e vogla në këto zgjedhje, pasi nuk parashikon formimin e koalicioneve parazgjedhore.⁷

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet parlamentare rregullohen nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor i vitit 2008, si dhe ligje të tjera.⁸ Legjislacioni primar plotësohet nga vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së. Shqiperia është palë e mekanizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.⁹

Para zhvillimit të këtyre zgjedhjeve, ndryshimet në ligjin zgjedhor për të marrë parasysh rekomandimet më të fundit të OSBE/ODIHR-it, u diskutuan në një komision parlamentar ad hoc, por procesi u bllokua për shkak të mosdakortësisë politike. Pas marrëveshjes, më 21 maj, dekreti i Presidentit për thirrjen e zgjedhjeve u ndryshua, duke shtyrë datën e zgjedhjeve më 25 qershor dhe parlamenti, më 22 maj, miratoi ndryshimet në ligjin “Për partitë politike”, ligjin “Për mediat audiovizive”, dhe Kodin Penal.¹⁰ Në Kodin Zgjedhor nuk u bë asnjë ndryshim.

Këto ndryshime përfshinë kërkesa të reja për fushatën dhe financimin e fushatës, transmetimin e reklamave zgjedhore nga mediat, rriti sanksionet mbi krimet ekzistuese zgjedhore, si dhe njohu krime të reja zgjedhore.¹¹ Ndryshimet në legjislacion u kritikuan nga disa bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it si kontradiktore me Kodin Zgjedhor, dhe të pa konsultuara më parë.¹² Këto ndryshime, të miratuara pak më shumë se një muaj para ditës së zgjedhjeve, parashtruan gjithashtu sfida ligjore dhe praktike për autoritetet dhe garuesit.

⁵ Partia Agrare Ambientaliste (PAA), e cila ishte pjesë e opozitës parlamentare, aplikoi për të marrë pjesë, por nuk depozitoi listat e kandidatëve.

⁶ Marrëveshja gjithashtu përfshin vijueshmërinë e procesit të reformës në drejtësi dhe asaj zgjedhore, futjen e teknikave të votimit elektronik për periudhën e ardhshme legjislative, si dhe institucionalizimin e dialogut ndërmjet dy kryetarëve të partive.

⁷ Shiko psh, deklaratën e datës 21 maj të Presidentit Bujar Nishani, ku ai “...e vlerëson këtë marrëveshje si një arritje të rëndësishme në interes të kombit shqiptar dhe qytetarëve të tij”.

⁸ Përfshirë ligjin “Për partitë politike”, të vitit 2000, ligjin “Mbi demostrimet” të vitit 2001, ligjin “Për mediat audiovizive” të vitit 2013, ligjin “Për dekriminalizimin” të vitit 2015, ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri” të vitit 2008, si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

⁹ Duke përfshirë Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit për Gratë, Konventa e KB kundër Korrupsionit, dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

¹⁰ Autoritetet theksuan se disa ndryshime pasqyroan punën e Komisionit Parlamentar mbi Reformën Zgjedhore.

¹¹ Veprat e reja penale përfshijnë abuzimin me funksionet publike për aktivitetet zgjedhore, përdorimin e paautorizuar të dokumentave të identifikimit, dhe ndalime më të detajuara mbi shitjen dhe blerjen e votës.

¹² Sipas Kushtetutës, kodet miratohen me shumicë të cilësuar të votave, ndërsa ligjet e zakonshme miratohen me shumicë të thjeshtë.

Të 140 deputetët e Parlamentit zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare në një sistem proporcional, me zona zgjedhore shumë-emërore, që i korrespondojnë qarqeve administrative të vendit. Bazuar në të dhënat për popullsinë nga Ministria e Brendshme, më datë 3 dhjetor 2016, KQZ-ja llogariti mandatet për çdo qark, duke i renditur nga 3 në Kukës në 34 në Tiranë - një vendim i miratuar nga Parlamenti.¹³

Për marrjen e një mandati, partitë duhet të kalojnë pragun prej tre përqind të votave të vlefshme në zonën zgjedhore përkatëse (pesë përqind për koalicionet).

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet administrohen nga një sistem administrimi me tre nivele: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 90 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), dhe 5,362 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Votat do të numërohen nga Grupet e Numërimit në 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV), të vendosura në 90 Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ).

KQZ-ja është organi i vetëm i përhershëm për administrimin e zgjedhjeve. Të shtatë anëtarët, përfshirë dy gra, emërohen nga Parlamenti. Tre anëtarë propozohen nga mazhoranca parlamentare dhe tre të tjerë propozohen nga opozita parlamentare. Sipas ligjit, kryetari miratohet nga Parlamenti përmes një procesi të hapur aplikimi.¹⁴ Sipas marrëveshjes, më 22 maj, Parlamenti aprovoi propozimin e PD-së për të zëvendësuar Kryetarin e KQZ-së me një anëtar tjetër të KQZ-së, duke shmangur procedurat ligjore në fuqi.

Për shkak të Marrëveshjes, KQZ-ja duhet të vepronte në kushte të jashtëzakonshme, duke u përballur me një tërësi komplekse sfidash ligjore, institucionale dhe financiare, si dhe me afate kohore të kufizuara që përbënin një ngarkesë shtesë. KQZ-ja duhej të hartonte një sërë udhëzimesh për monitorimin e financimit të fushatës, për të qartësuar udhëzimet e reja të fushatës, dhe për të miratuar vendimet për regjistrimin e partive dhe të kandidatëve, pa një bazë ligjore. Pavarësisht këtyre sfidave, KQZ-ja vazhdoi të merrte dhe të publikonte vendimet e saj rregullisht. KQZ-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it, që planifikonte të kërkonte fonde shtesë nga Qeveria për të siguruar burimet e duhura për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi të reja.

KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë, të propozuar nga mazhoranca dhe opozita parlamentare.¹⁵ Të paktën 30 përqind e anëtarëve të KZAZ-së të propozuar nga partitë më të mëdha mazhoritare dhe të opozitës, duhet të jenë gra. Partitë opozitare, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të komisioneve të dyta dhe të treta, dështuan në propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve brenda afateve kohore të vendosura më parë. Për këtë arsye, sikurse dhe ligji e parashikon, KQZ-ja bëri thirrje për aplikim nga qytetarët që përmbushin kriteret. Dy javë pas përfundimit të afatit ligjor, KQZ-ja, formoi KZAZ-të me vetëm katër anëtarë dhe një sekretar secila.¹⁶ Më 31 maj, sipas Marrëveshjes, KQZ-ja shkarkoi të emëruarit e saj dhe plotësoi 252 vendet vakante me të propozuarit nga PD-ja. Më herët një numër i vogël anëtarësh dhe sekretarësh të KZAZ-ve u zëvendësuan, pjesa më e madhe e tyre, për

¹³ Parlamenti miratoi ndarjen e mandateve më 20 prill 2017, pak a shumë pesë javë pas afatit ligjor.

¹⁴ Në nëntor 2016, ish-Nënkryetari i KQZ-së i propozuar nga PS-ja u zgjodh kryetar.

¹⁵ Formula e propozimeve për KZAZ-të, pasqyron atë të KQZ-së, me përjashtimin që në gjysmën e KZAZ-ve kryetari propozohet nga partia më e madhe mazhoritare, dhe në gjysmën tjetër nga partia më e madhe opozitare. Zëvendësi kryetari dhe sekretari i perkasin partisë më të madhe politike, që nuk kryeson KZAZ-në përkatëse.

¹⁶ Kodi Zgjedhor parashikon, që nëse partitë dështojnë për të propozuar të emëruarit e tyre, KQZ-ja emëron anëtarët e KZAZ-ve me iniciativën e saj. Prandaj, të gjitha KZAZ-të kishin tre persona (anëtarë dhe/ose sekretarë të KZAZ-ve) nga PS-ja, një nga LSI-ja, dhe një të emëruar nga KQZ-ja. Kuorumi, që KZAZ-ja të marrë një vendim, është katër nga shtatë anëtarë.

shkak të kërkesave të partive që i propozonin.¹⁷ KQV-të, gjithashtu janë të përbëra nga shtatë anëtarë dhe duhet të miratohen nga KZAZ-të deri më 5 qershor, sipas të njëjtës formulë si për KZAZ-të.

Për shkak të bllokimit politik dhe ndryshimit të datës së zgjedhjeve, KQZ-ja filloi fushatën e saj informuese për zgjedhësit më 26 maj. KQZ-ja vijon zbatimin e iniciativave të ndryshme mbi informimin e zgjedhësve për rritjen e pjesmarrjes së grave, pakicave kombëtare, personave me aftësi të kufizuar, dhe zgjedhësve që votojnë për herë të parë.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Shtetasit e moshës 18 vjeç ose më shumë, gjatë ditës së zgjedhjeve kanë të drejtë vote, me përjashtim të atyre që janë shpallur të paafte mendërisht me vendim gjykate si dhe atyre që vuajnë dënimin në burg për kryerjen e veprave penale të ndryshme.¹⁸

Shqipëria ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve; megjithatë, zgjedhës të moshës 100 vjeç ose më shumë, hiqen automatikisht nga lista e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë të dhënat e tyre për t'u ri-futur në listë.¹⁹ Listat e zgjedhësve nxirren nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në MB. Garuesve zgjedhorë u jepet një kopje e listave të zgjedhësve sipas kërkesës së tyre, pa pagesë.

Çdo ndryshim në gjëndjen civile të qytetarëve, duhet të regjistrohet pranë zyrave vendore të gjendjes civile. Ndryshimet e të dhënave të zgjedhësve mund të bëhen deri 40 ditë përpara zgjedhjeve. Por, përveç kësaj, edhe deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve, kërkesat për të korrigjuar listën e zgjedhësve mund të bëhen vetëm nëpërmjet gjykatave të rretheve. DPGJC-ja shpall ekstraktin e përditësuar të listës së zgjedhësve çdo muaj dhe këto lista janë të disponueshme për shqyrtim publik. Gjithashtu, zgjedhësit mund t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në faqen e internetit të KQZ-së. Pas Marreveshjes, u përpiluan dhe u printuan listat e reja të zgjedhësve, të cilat pasqyrojnë edhe zgjedhësit të cilët do të mbushnin 18 vjeç deri në ditën e re të zgjedhjeve. Në janar 2017, KQZ-ja caktoi dy auditues për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve. Pavarësisht faktit se audituesit vunë re disa adresa të pasakta, nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it nuk u ngritën problematika thelbësore.

Zgjedhësit janë përfshirë në listat e zgjedhësve të Qendrave të Votimit pranë vendbanimit të tyre. Ata duhet të votojnë vetë personalisht, dhe nuk ka asnjë parashikim ligjor për votimin nga jashtë vendit, nëpërmjet postës apo nëpërmjet kutisë së votimit të lëvizshme. Qendra të posaçme votimi, mund të ngrihen pranë spitaleve, burgjeve dhe qendrave të paraburgimit. Zgjedhësit që jetojnë jashtë vendit, janë në listat e zgjedhësve sipas adresës së tyre të regjistruar më së fundi. Deri më 24 maj, numri total i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,452,308.

VII. PROPOZIMET DHE REGJISTRIMET E KANDIDATEVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote mund të jetë kandidatë për zgjedhjet, përveç atyre që vuajnë dënim me burg ose janë dënuar më parë për krime specifike.²⁰ Kushtetuta gjithashtu liston kategoritë e zyrtarëve, aktivitetet e të cilëve nuk përputhen me të drejtën për të kandiduar. Kandidatët e pavarur mund të

¹⁷ Pavarësisht rekomandimeve të hershme të OSBE/ODIHR-it, partitë kanë në diskrecionin e tyre të drejtën të tërheqin të emëruarit e tyre nga KZAZ-të.

¹⁸ Ligji "Për dekriminalizimin" ka futur kufizime mbi të drejtën e votimit të shtetasve, që vuajnë dënimin me burgim për kryerjen e krimeve të listuara në rreth 50 nene të Kodit Penal. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua, që e drejta e votës i ishte pezulluar 1371 personave.

¹⁹ Sipas DPGJC-së, 1480 zgjedhës mbi 100 vjeç, ishin fshirë nga lista e zgjedhësve nga dhjetori 2016 deri më 24 maj 2017.

²⁰ Sipas ligjit "Për dekriminalizimin" shtetasit e dënuar për disa lloje krimesh apo të deportuar, edhe në mungesë, me një vendim të formës së prerë, nga shtetet anëtare të BE-së, Australia, Kanadaja, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e kanë të ndaluar për të kandiduar në zgjedhje, si edhe ata që janë në kërkim ndërkombëtar.

kandidojnë për zgjedhje nëpërmjet propozimeve të grupeve të zgjedhësve.²¹ Listat e kandidatëve mund të paraqiten nga partitë politike dhe koalicionet partiake.²² Listat me dokumentacionin mbështetës të kërkuar, verifikohen nga KQZ-ja në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe ligjin “Për dekriminalizimin”. Disa nga bashkëbiseduesit e OSBE/ODIHR-it ngritën shqetësimin rreth përputhjes, afateve të shkurtra dhe cilësisë së verifikimeve të kandidatëve me të shkuar kriminale dhe fimave mbështetëse.²³

Më 7 maj, dy ditë para afatit ligjor, KQZ-ja regjistroi listat e 15 partive.²⁴ Një ditë më pas, KQZ-ja aprovoi përmbajtjen e fletëve të votimit, një vendim i cili u perceptua nga disa bashkëbisedues si i politizuar, pasi KQZ-ja nuk priti për ankimimet e mundshme kundër regjistrimit. Më 28 dhe 30 maj, pas Marrëveshjes dhe përtej afateve ligjore, KQZ-ja regjistroi listat e kandidatëve për PR-në, Partinë Bashkimi Demokristian Shqiptar dhe PD-në.²⁵ Në të njëjtën kohë, një kandidat i pavarur iu mohua regjistrimi për shkak të dorëzimit të vonë të dokumentave.²⁶ Në total u regjistruan 2,672 kandidatë, 40 përqind e tyre gra.

Kuotat gjinore aplikohen për çdo listë kandidatësh dhe për përmbushjen e tyre kërkohet që të paktën një grua dhe një burrë të jenë në tre vendet e para, dhe që të paktën 30 përqind e kandidatëve në listë të jenë të gjinisë tjetër. Deri më 30 maj, KQZ-ja vuri sanksione monetare prej 1 milion Lek (rreth 7,400 Euro) ndaj listave të PS-së dhe LSI-së, për mosrespektimin e kërkesave gjinore respektivisht në rajonet e Beratit dhe Tiranës.²⁷ Ligji nuk i jep të drejtën KQZ-së të mohojë regjistrimet nëse kuotat nuk respektohen.

VIII. MJEDISI ZGJEDHOR DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Sipas Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore fillon zyrtarisht fillon 30 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para kësaj dite. Nuk ka asnjë sanksion për fillimin më herët të fushatës. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka vëzhguar raste të fushatës jashtë afateve ligjore, në të dy rastet, para dhe pas ndryshimit të datës së zgjedhjeve, ku përfshihen disa postera dhe disa tubime zgjedhore.²⁸ Deri më tani fushata ka qenë modeste.²⁹

Fushata në institucionet publike është e ndaluar. Burimet e institucioneve apo enteve publike nuk mund të përdoren në fushatë, dhe nëpunsi civil nuk mund të marrë pjesë në aktivitete politike gjatë orarit zyrtar. Më 12 maj, Kryeministri nxorri një urdhër mbi ndalimin e përdorimit të burimeve të

²¹ Grupet e zgjedhësve duhet të përbëhen nga e pakta nëntë votues dhe të regjistrohen në KQZ për të mbledhur firmat e një përqind të zgjedhësve në zonën përkatëse (zonë zgjedhore), por jo më shumë se 3000.

²² Partive parlamentare nuk u kërkohet të mbledhin firma. Lista e kandidatëve e partive jo parlamentare duhet të firmoset nga 5000 mbështetës në rang vendi.

²³ Gjatë mbledhjes së datës 7 maj, tre anëtarët e KQZ-së propozuar nga opozita, kërkuan verifikime të mëtejshme të firmave të mbështetësve për pesë partitë. Megjithatë, katër anëtarët e KQZ-së të propozuar nga mazhoranca, e rrëzuan këtë kërkesë. Anëtarët e opozitës u larguan nga mbledhja.

²⁴ Para Marrëveshjes, KQZ-ja mori listat e kandidatëve nga 17 parti, dy nga të cilat (Bashkimi Kombëtar Shqiptar dhe Partia Socialiste e Moderuar) nuk i riparaqitën listat pasi KQZ-ja ua ktheu për plotësim.

²⁵ Parlamenti nuk ka miratuar afate të reja regjistrimi. Bazuar në Kodin Zgjedhor, pas vendosjes së datës së re të zgjedhjeve, partitë politike duhej të regjistroheshin jo më vonë se 16 prill dhe lista e kandidatëve jo më vonë se 16 maj.

²⁶ Më 26 maj, KQZ-ja rrezoi kërkesën e një kandidati të pavarur, i cili paraqiti dokumentacionin mbështetës më datë 25 maj, me arsyetimin se ai kishte shkelur afatin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

²⁷ 1 Euro është afërsisht 135 Lek.

²⁸ Njoftime, të cilat ftonin zgjedhësit në takim me një kandidat të PDIU-së më 12 maj, në mjediset e një shkolle, janë vërejtur nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR në Peshkopi. MVZ-ja e OSBE/ODIHR vëzhgoi takimet e PS-së me votues më 19 maj në Korçë, më 23 maj në Durrës dhe më 25 maj në një tubim të LSI-së në Kukës.

²⁹ Më 27 maj, PD-ja mbajti një tubim zgjedhor në Tiranë, në të cilin morrën pjesë me mijëra njerëz. Në vijim të eventit, Ministria e Brendshme deklaroi, se 73 persona kërkuan ndihmë mjeksore për shkak të irritimit të syve dhe lëkurës. Më 28 maj, Ministria e Shëndetësisë deklaroi, se 140 njerëz kërkuan ndihmë të shpejtë, 14 prej të cilëve janë shtruar në spital. Hetimet po vazhdojnë.

administratës publike në fushatë zgjedhore, duke rikonfirmuar kështu parashikimet ligjore. Sipas Marrëveshjes, opozitës iu dhanë pozicione kyçe në ministri dhe institucione publike, si mbrojtje ndaj një abuzimi të mundshëm të burimeve administrative.³⁰ Bashkëbisedues të ndryshëm të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it kanë shprehur shqetësimin për një shit-blerje të mundshme të votës.

Ndryshimet në ligjin “Për partitë politike” më 22 maj përfshinë kufizime të fushatës, të cilat nuk parashikoheshin në Kodin Zgjedhor. Specifikisht, këto ndryshime kërkonin nga KQZ-ja që të përcaktonte llojet e aktiviteteve, shërbimeve dhe materialeve, që mund të përdoren në fushatë. Veç kësaj, vendosja e materialeve zgjedhore është e lejueshme vetëm brenda një distance prej pesë metrash larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.

Fondet publike i shpërndahen partive për aktivitetin e tyre, sipas ligjit “Për partitë politike”, bazuar në rezultatin e tyre në zgjedhjet e fundit parlamentare. Fonde publike për fushatën, i shpërndahen gjithashtu të gjitha partive garuese në zgjedhje, me një buxhet total për këto zgjedhje, që arrin në shifrën 65 milion Lek.³¹ Kandidatët e pavarur nuk përfitojnë nga këto fonde publike. Garuesit zgjedhor mund të marrin donacione nga qytetarët apo dhe entet ligjore, të marrin hua apo të përdorin fondet e tyre. Asnjë donacion nuk mund të kalojë shumën prej 1 milion Lek, duke përfshirë vlerën korresponduese në natyrë. Të gjitha donacionet, që kalojnë shumën 100.000 Lek duhet të bëhen nëpërmjet një llogarie të posaçme bankare.

Kodi Zgjedhor përcakton një limit të njëjtë shpenzimi për çdo parti politike garuese në zgjedhje.³² Megjithatë, bazuar në ndryshimet, që u bënë më 22 maj në ligjin “Për partitë politike”, i kërkohej KQZ-së që të përcaktojë një limit specifik për shpenzimet e fushatës për secilën parti politike.³³

KQZ-ja ka gjithashtu për detyrë, që të detajojë rregulla për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për garuesit, si dhe udhëzime për përlllogaritjen e shpenzimeve për aktivitetet, shërbimet dhe materialet e fushatës dhe të caktojë ekspertë financiarë për monitorimin e saj; KQZ-ja ende nuk e ka zbatuar këtë detyrim të ligjit. Ekspertët financiar duhet të raportojnë në KQZ jo më vonë se katër muaj nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Një tjetër kërkesë për raportim është përcaktuar për garuesit: brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, çdo parti politike, që është regjistruar në zgjedhje, duhet të bëjë publik dhe të dorëzojë pranë KQZ-së një raport për deklarimin financiar për të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës.

IX. MEDIA

Klima mediatike në Shqipëri është aktive dhe e tejngopur. Ajo përfshin transmetues publik dhe privat, dhe një shumëllojshmëri të medias elektronike dhe të shkruar. Numri, shumëllojshmëria dhe aksesimi i madh në rrjetin mediatik mund të ofrojë zgjedhësve informacion të ndryshëm dhe të bollshëm rreth politikës dhe zgjedhjeve, kryesisht nëpërmjet lajmeve dhe debateve rreth zgjedhjeve. Megjithatë, interesat ekonomike dhe politike të pronarëve të mediave, shpesh influencojnë raportimet e gazetarëve, duke krijuar një perceptim të gjerë, që mediat janë të polarizuara fuqishëm sipas linjave partiake. Televizioni (TV) është burimi kryesor i informacionit politik, ku TV-të private *Klan*, *Top Channel*, dhe *Vizion Plus* janë kanalet më popullore. Prej shtypit, *Panorama* aktualisht ka lexueshmërinë më të lartë,

³⁰ Përfshin këta ministra të rinj: Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë, si edhe Drejtori i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë, Drejtori i Aluiznit, Drejtori i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtori i Burgjeve, dhe Drejtori i Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor.

³¹ Partitë, që kanë marrë më shumë se 0.5 përqind të votave të vlefshme gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare, marrin 95 përqind të fondit, në proporcion me numrin e votave të vlefshme të marra. Pesë përqindshi i mbetur u shpërndahet partive të cilat marrin më pak se 0.5 përqind të votave dhe partive të cilat nuk marrin pjesë në zgjedhjet e fundit.

³² Sipas Kodit Zgjedhor, një parti politike nuk mund të shpenzojë 10 herë më shumë se shuma më e madhe, që një garues ka marrë nga fondet publike. Një kandidat i pavarur nuk duhet të shpenzojë më shumë se 50 përqind të shumës më të madhe të marrë nga një garues nga fondet publike.

³³ KQZ-ja nuk ka mundur të sqarojë MVZ-së së OSBE/ODIHR-it kuptimin e kësaj dispozite të re.

por portalet online dhe mediat sociale janë duke zëvendësuar në mënyrë të shpejtë median e shkruar, duke u kthyer në burimin kryesor të informimit të zgjedhësve.

Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes, lirinë e medias, të drejtën për t'u informuar dhe ndalon censurën e mejeve të komunikimit. Shpifja konsiderohet si vepër penale, por ndërkohë prej 2012 ndëshkohet vetëm me gjobë. Aktivitetet e transmetimit të medias jashtë periudhës zgjedhore, rregullohen me ligjin "Për mediat audiovizive", ndërsa mediat e shkruara, më së shumti vetërregullohen.

Mbulimi i fushatës në median audiovizive rregullohet me Kodin Zgjedhor në mënyrë të detajuar. Në transmetimet e tyre të lajmeve, të gjithë transmetuesve publik dhe privat u kërkohet të sigurojnë kohë të barabartë për mbulimin e partive, që marrin pjesë në zgjedhje me më shumë se 20 përqind të vendeve në Parlament. Çdo parti tjetër parlamentare do të marrë gjysmën e kësaj kohe, ndërsa mbulimi i partive jo parlamentare, që garojnë për zgjedhje lihet në diskrecion të redaktorëve dhe nuk mund të tejkalojë mbulimin, që u është dhënë partive partive të vogla parlamentare. Mbulimi i institucioneve publike, të cilat promovojnë arritje institucionale, të tilla si inagurimi i punimeve publike, konsiderohet i lidhur me fushatën dhe llogaritet në minutazhin e partisë që ka emëruar kreun e institucionit.

Transmetimi i informacioneve për fushatën gjatë edicioneve të lajmeve, bazuar në filmimet e regjistruar nga vetë partitë, lejohet ende, edhe pse është në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Më 23 maj, transmetuesi publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) njoftoi se nuk do të pranonte më filmime të regjistruara nga partitë.

Më 15 maj, në përputhje me Kodin Zgjedhor, KQZ-ja shpërndau minutazh falas në RTSH, për të gjitha partitë politike që garojnë në zgjedhje, duke u bazuar në përfaqësimin e tyre në Parlament deri në atë ditë. PS-ja, e cila mban më shumë se 20 përqind të vendeve në Parlament, morri 60 minuta kohë; LSI-ja, PDIU-ja dhe PKD-ja (me më pak se 20 përqind të vendeve në Parlament) morrën 30 minuta secila; 11 partitë garuese pa vende në Parlament morrën nga 10 minuta secila. Renditja e transmetimit u përcaktua me short. Pas Marrëveshjes, më 30 maj, edhe tre partive të sapo regjistruara iu caktua gjithashtu minutazh falas. Deri më 31 maj, RTSH-ja nuk ka transmetuar minutazh falas për asnjë nga garuesit.

Marrëveshja solli ndryshime të ligjit për partitë politike, duke detyruar mediat private të sigurojnë minutazh falas për reklamat politike të partive, që garojnë në zgjedhje.³⁴ Përveç kësaj reklamat politike me pagesë u ndaluan për këto zgjedhje, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Më 25 maj, 10 media private paraqitën në KQZ një letër, duke deklaruar, që ata do të zbatojnë Kodin Zgjedhor dhe nuk do të zbatojnë ndryshimet, të cilat i konsiderojnë si jokushtetuese.

Më 19 prill, nëntë ditë pas afatit, KQZ-ja caktoi Bordin e Monitorimit të Medias (BMM) për të monitoruar fushatën zgjedhore tek transmetuesit publik dhe privat.³⁵ BMM-ja i paraqet KQZ-së një raport ditor, i cili mund të përmbajë gjithashtu propozime për sanksione administrative. KQZ-ja shqyrton raportet të paktën një herë në javë dhe merr një vendim, nëse propozohen sanksione administrative. Deri më 26 maj, BMM-ja filloi të monitorojë 13 operatorë audiovizivë, që transmetojnë nga Tirana dhe 25 operatorë, që transmetojnë nga 8 rajone të ndryshme. Deri më 29 maj, pavarësisht moslejimit ligjor, reklamat e dy institucioneve shtetërore vazhduan të transmetohen në RTSH dhe në

³⁴ Partia më e madhe e mazhorancës dhe e opozitës kanë të drejtën të kenë 90 minuta; partitë e tjera parlamentare nga 45 minuta; partitë jo parlamentare nga 10 minuta.

³⁵ BMM-ja përbëhet nga shtatë anëtarë. Çdo anëtar i KQZ-së cakton një anëtar në BMM nga lista e propozuar nga organizatat kombëtare jo fitim prurëse mediatike.

disa kanale televizive private.³⁶ Në raportin e 28 majit, BMM-ja i propozoi KQZ-së marrjen e masave për të ndaluar transmetimin e spoteve.

Më 15 maj, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi monitorimin të një kampioni mediatik duke përdorur analizë cilësore dhe sasore të mbulimit të tyre politik.³⁷

X. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Sipas Kodit Zgjedhor, vendimet e KZAZ-ve mund të ankimohen në KQZ nga garuesit, brenda tre ditëve nga data e vendimit (pesë ditë për rezultatin e zgjedhjeve). Asnjë ankim i tillë administrativ nuk ishte bërë gjatë periudhës së raportimit. Vëzhguesit vendor mund të ankimojnë vendimet e KQZ-së dhe KZAZ-së mbi akreditimet e tyre. Ligji nuk e përcakton qartë një institucion përgjegjës për ankimet mbi shkeljet në fushatë. KQZ-ja duhet të marrë vendim për ankimet mbi rezultatin e zgjedhjeve brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit, por afati nuk është i përcaktuar qartë në ligj për llojet e tjera të ankimeve.³⁸

Procedura e ankimit administrativ në KQZ është e hollësishme dhe përfshin caktimin e një relatori, verifikimin paraprak, seancë rishikuese, dhe pranueshmërinë për çdo kërkesë ankimore. Ankimet, të cilat nuk përmbushin kërkesa formale, i kthehen kërkuarit për plotësim.

Garuesit mund të ankimojnë vendimet, si dhe mosmarrjen e vendimeve nga ana e KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.³⁹ Ankimet në Kolegjin Zgjedhor gjykohen nga një panel prej pesë gjyqtarësh, i cila në çdo rast zgjidhet me short. Gjatë periudhës zgjedhore, vendimi duhet të jepet brenda 10 ditëve. Deri më tani, tre ankime, që lidhen me zgjedhjet parlamentare janë paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor. Kolegji detyroi KQZ-në, që të marrë vendim mbi kërkesën për regjistrim të një partie politike.⁴⁰ Dy kërkesë padi të tjera ankimuan vendimet e KQZ-së mbi regjistrimin e listës së kandidatëve, të cilët pretendonin që listat ishin paraqitur nga partitë politike jashtë afatit ligjor.⁴¹ Por sipas Marrëveshjes, kërkuarit hoqën dorë.

Kërkesa për të ndryshuar të dhënat e zgjedhësve pas mbylljes së listës së zgjedhësve, mund të bëhet nga zgjedhësit pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe duhet të merret vendim brenda pesë ditëve, por jo më vonë se gjashtë orë para mbylljes së votimit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, deri tani, nuk është në dijeni të ndonjë kërkesë të tillë.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kushtetuta e Shqipërisë garanton të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat, dhe Kodi Zgjedhor garanton të drejtën e votës dhe të drejtën për të kandiduar në zgjedhje për të gjithë qytetarët, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike, racore, fetare apo gjuhësore. Ligji Shqiptar nuk e parashikon krijimin e partive të pakicave kombëtare. Anëtarët e pakicave kombëtare mund të kandidojnë në zgjedhje si me partitë specifike të pakicave kombëtare dhe partitë politike të përgjithshme.

³⁶ *ABC News, News 24, Ora TV, RTSH, Top Channel, TV Klan dhe Vizion Plus* transmetuan spote të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministria e Inovacionit dhe Administrimit Publik.

³⁷ Transmetimet në orët me shikueshmëri më të lartë (nga ora 18:00 deri në orën 24:00) të pesë kanaleve televizive (RTSH, dhe kanalet private *Top Channel, TV Klan, Vizion Plus dhe ABC News*), një gazetë ditore nga shtypi i shkruar (*Panorama*), dhe tre portale online (*balkanweb.com, syri.net dhe gazetatema.net*).

³⁸ Sipas KQZ-së, afati 10 ditore aplikohet në të gjitha ankimet.

³⁹ Kolegji është i përbërë nga tetë gjyqtarë të zgjedhur me short ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit në Shqipëri për katër vjet. Kolegji Zgjedhor aktual u krijua në dhjetor të 2016 dhe përfshin një gjyqtare femër.

⁴⁰ Partia LIBRA, e themeluar rishtazi, i kërkoi KQZ-së të njihte, që ajo plotësonte kërkesat ligjore për regjistrimin e partive parlamentare për zgjedhjet, pasi kishte dy deputetë në Parlament.

⁴¹ PAA-ja dhe Partia Aleanca Popullore argumentuan, që paraqitja e listave të kandidatëve më 29 prill, dita e 50-të para zgjedhjeve të 18 qershorit, ishte pas afatit kohor të parashikuar në Kodin Zgjedhor “jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve”.

Bazuar në censusin e 2011, më pak se 1.5 përqind e popullsisë në Shqipëri vetëdeklarohen si pakica kombëtare.⁴² Në zgjedhjet e shkuara, vetëm pakicat kombëtare greke kanë rezultuar të suksesshëm në fitimin e mandateve në Parlament nëpërmjet një partie të pakicave kombëtare. Përfaqësues të grupeve të vogla të pakicave i kanë sugjeruar MVZ-së së OSBE/ODIHR-it që sistemi zgjedhor mund të reformohet duke vendosur një prag më të ulët për pakicat kombëtare.

KQZ-ja nxorri informacion për votuesin në gjuhët greqisht, maqedonisht, rome, serbe dhe vllehe/arumune. Të gjithë bashkëbiseduesit e OSBE/ODIHR-it ndihen të lehtësuar me përdorimin e gjuhës së tyre në publik gjatë fushatës zgjedhore. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk është në dijeni të ndonjë ankimi lidhur me ndonjë formë diskriminimi apo trajtimi të padrejtë për shkak të përkatësisë etnike të një personi. Disa zgjedhës nga komuniteti Rom ende hasin pengesa praktike, që kanë të bëjnë me regjistrimin e zgjedhësve për shkak të një numër faktorësh, duke përfshirë mungesën e dokumentacionit dhe mospasjen e një banese fikse. Disa nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it kanë vërejtur, që praktika e blerjes së votës në zonat me përqidje të lartë të popullsisë së minoritetit Rom, mund të përbëjë problem.

XII. VËZHguesIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Garuesit kanë të drejtë të emërojnë një vëzhgues në çdo KZAZ, KQV dhe tavolinë numërimi në VNV. Partitë parlamentare mund të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, ndërsa partitë e tjera kanë të drejtën të caktojnë përfaqësues për të ndjekur mbledhjet e KQZ-së vetëm gjatë periudhës zgjedhore. Deri më 31 maj, KQZ-ja ka akredituar një total prej 102 vëzhguesish vendor.

XIII. AKTIVITETET E MVZ-SË SË OSBE/ODIHR-IT

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it e çeli aktivitetin e saj në Tiranë me një konferencë për shtyp më 9 maj. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u takua me autoritetet qeveritare, KQZ-në, përfaqësues të partive politike, median, shoqërinë civile, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, dhe komunitetin ndërkombëtar.⁴³ Asambleja Parlamentare e OSBE-së, Asambleja Palamentare e Këshillit të Evropës, dhe Parlamenti Evropian kanë për qëllim të vendosin delegacione vëzhguese për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve. Z. Roberto Battelli nga Sllovenia është caktuar nga Kryetari i rradhës i OSBE-së si Koordinator i Posaçëm për të kryesuar vëzhguesit afatshkurtër të OSBE-së.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.
Një përkthim jozyrtar është i disponueshëm në gjuhën shqipe.*

⁴² Pakicat kombëtare greke përllongariten të jenë 0.87 përqind e popullsisë, rome - 0.3 përqind, dhe maqedonase - 0.2 përqind. Është e rëndësishme të vërehet, që 14 përqind e të pyeturve zgjedhës të mos i përgjigjen pyetjes rreth etnicitetit, duke vënë në pikëpyetje saktësinë e të dhënave të censusit në lidhje me pakicat kombëtare.

⁴³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri veprojnë veçmas sipas mandateve të tyre përkatëse.